

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA E STUDENTEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **208/90500-26-4810-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi ,montimi dhe funksionalizimi i pajisjeve të zërimit në palestër**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	AVC Group Sh.p.k.
NUI	600036851
Adresa	Rr.Bardhyl Qaushi;Kompleksi KAWA Hy.C
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	+38349243367
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Illir Gorani
Adresa elektronike	info@avc-group.cc
Data e parashtrimit të ankesës	06.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizimi ,montimi dhe funksionalizimi i pajisjeve të zërimit në palestër

1. Njoftimi për kontrate i datës: 18.06.2026

2. Afati për dorëzimin e ofertave/kërkesës për pjesëmarrje i datës: 08.07.2026

3. Sqarime shtesë i datës: 29.06.2026

4. Vendim mbi kërkesën për Rishqyrtim 02.07.2026

5. E KORIGJUAR -B27 Dosja e tenderit për kontrata kornizë 02.07.2026

6. I KORIGJUAR Pjesa II Pershkrimi i cmimit 02.07.2026

7. Vendim mbi kërkesën për Rishqyrtim 03.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Lënda: Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi ,montimi dhe funksionalizimi i pajisjeve të zërimit në palestër”, Kodi i procedurës: 208/90500-26-4810-1-2-1

Ankues: AVC GROUP sh.p.k., Prishtinë

Kundër: QENDRA E STUDENTEVE, Prishtinë

Operatori Ekonomik AVC GROUP sh.p.k. paraqet këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 03.07.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim lidhur me kriteret e dosjes së tenderit për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi ,montimi dhe funksionalizimi i pajisjeve të zërimit në palestër”.

Vlerësojmë se kriteret e kontestuara janë në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), veçanërisht me parimet e konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Te pa kënaqur me përgjigjen e dhënë nga AK-ja në kërkesen për rishqyrtim të datës 03.07.2026 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- Qendra e Studenteve ne lidhje me aktivitetin e prokurimit:

"Furnizimi ,montimi dhe funksionalizimi i pajisjeve të zërimit në palestër" ne afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojmë këtë:

ANKESË

Për shkak se AK- Qendra e Studenteve në përgjigjen e dhënë në kërkesen për rishqyrtim të dhënë vlerësojmë se kriteret e kontestuara janë në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (i ndryshuar dhe plotësuar), veçanërisht me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë.

I. BAZA LIGJORE

Kjo ankesë parashtrohet në bazë të:

- Neni 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar;
- Neni 1 të LPP-së - Qëllimi i Ligjit; Shkeljet e LPP-së nga ana e AK-së;
- Neni 7 të LPP-së - Barazia në Trajtim, Mosdiskriminimi dhe Transparenca;
- Neni 28 të LPP-së - Specifikimet Teknike;
- Neni 25.4 dhe 25.6 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik;
- Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik.

II. RRETHANAT FAKTIKE

Autoriteti Kontraktues, Qendra e Studenteve, ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi ,montimi dhe funksionalizimi i pajisjeve të zërimit në palestër".

Pas analizimit të Dosjes së Tenderit, operatori ekonomik AVC GROUP sh.p.k.ka konstatuar se një numër i konsiderueshëm i kriterëve të kualifikimit profesional, teknik dhe organizativ:

- nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës;
- nuk janë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e projektit;
- kufizojnë në mënyrë të panevojshme pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë;
- krijojnë barriera artificiale për konkurrencën;
- krijojnë dyshim të bazuar se dosja e tenderit është hartuar në mënyrë të tillë që të favorizojë një operator ekonomik të caktuar.

Për këto arsye është ushtruar Kërkesa për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, e cila është refuzuar pa ofruar arsyetim të mjaftueshëm ligjor dhe teknik.

III. SHKELJA E PARIMEVE TË LPP-SË

Sipas nenit 1 të LPP-së, qëllimi i ligjit është:

- përdorimi efikas, efektiv dhe transparent i fondeve publike;
- krijimi i konkurrencës sa më të gjerë ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- trajtimi i barabartë dhe jo-diskriminues i operatorëve ekonomikë.

Po ashtu, neni 7 i LPP-së obligon Autoritetin Kontraktues të sigurojë:

- konkurrencë të lirë dhe efektive;
- trajtim të barabartë;
- mosdiskriminim;
- proporcionalitet.

Neni 65 i LPP-së dhe neni 25.6 i Rregullores Nr.001/2022 përcaktojnë qartë se:

Çdo kërkesë minimale për karakteristika teknike duhet të jetë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues në vendimin e vet refuzues te datës 03.07.2026, vlerëson se "operatori ekonomik nuk ka argumentuar dhe as nuk ka dëshmuar se specifikimet teknike të mbetura janë diskriminuese, favorizojnë një operator ekonomik, prodhues apo markë të caktuar, apo krijojnë pengesa të pajustificuara për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit".

Në vijim i cekim pikat që favorizojnë një markë të caktuar dhe me kërkesa jo relevante, si psh. dizajni i kutisë së pajisjes si dhe për paisjet që do të vendosen në rack cabinet, pesha e pajisjes ose/edhe formati/dimensionet e saj krijojnë pengesë të pajustificuar për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit me këto kufizime jo relevante.

Konkretisht:

Poz.4. -

32 hyrje analoge **D-PRE** - maksimumi 48 kanale 2x 2TR in dhe USB në

GainFinder-Function

Pesha max 20 kg

Me të kaltër është pjesa e kerkesës që nuk është relevante.

Me te kuqe jane pjesët e kerkesës që e përcaktojnë prodhuesin Yamaha të cilat e kanë specifike teknologjinë D-PRE dhe modeli TF-5 i përgjigjet drejtë për drejtë të gjitha kërkesave te kësaj pozite. Problemi tjetër me këtë pozitë është që modeli TF-5 nuk prodhohet më dhe modeli me i afërt qe është i përgjegjshem është Yamaha DM-7.

Poz. 5. -

Ekran me prekje **kapacitive me definicion të lartë 7 inç, i ndërrueshëm në kinezisht dhe anglisht**

Me të kaltër është pjesa e kerkesës që nuk është relevante.

Poz. 6. -

Pesha max 25 kg

Poz 10. -

Pesha max 16.2 kg

Poz 11. -

Pesha max 19 kg

Poz 12. -

Pesha max 14 kg

Poz 13. -

Madhësia e Shasisë: 2U

Poz 14. -

Formati: 19"/ 2U

.....

dhe disa pozita të tjera me të kaltër nuk janë relevante.

Poz. 20. -

Kutia: Kompensatë thupre

Mbarimi: Veshje poliureane

Grila: Grilë çeliku e Iyer me shkumë të zezë

Me të kaltër është pjesa e kerkesës që nuk është relevante.

Poz. 21. -

LF: 1×15"(spirale zëri 3")

HF: 1×1"(spirale zëri 1.5")

Kutia: Kompensatë me shumë shtresa

Përfundimi: Veshje poliurea

Mbrojtja nga Hyrja: IP45 (Opsionale)

Grilë: Grilë çeliku e Iyer

Pesha max: 33.4KG

- Veshje industriale poliureje, miqësore me mjedisin, e papërshkueshme nga uji, anti-korrozioni, rezistente ndaj goditjeve dhe konsumimit

- Dizajn kompakt i kabinetit me pika të shumta varjeje

Me të kaltër është pjesa e kerkesës që nuk është relevante.

Poz.23. -

18. Furnizimi me Energji: AC110~240V, 50Hz/60Hz

19. Përmasat (Gjerësi x Thellësi x Lartësi): 482×260×45mm

20. Pesha e Transportit: 3KG

Me të kaltër është pjesa e kerkesës që nuk është relevante.

Poz.27. -

Skanim radari me bandë të plotë me një klikim, përfundon skanimin e frekuencës së plotë dhe përputhjen automatike të frekuencës brenda sekondave

Ekran me dritë prapa me dy ngjyra

Bateria: 2 bateri AA × 1.5V

Me të kaltër është pjesa e kerkesës që nuk është relevante.

Poz.28. -

9 priza energjie duke përfshirë 8 kanale kryesore 1 portë USB, madhësi standarde rafti 1U

Specifikimet: 1U 8-kanalësh

Me të kaltër është pjesa e kerkesës që nuk është relevante.

Poz.29. -

Dizajn i hollë 1U, i përshtatshëm për montim në raft 19"

Furnizim me energji: AC 180V-250V

Me të kaltër është pjesa e kërkesës që nuk është relevante.

Poz.30. -

Furnizim me energji: AC 220-240V/50-60Hz/20A

Me të kaltër është pjesa e kërkesës që nuk është relevante.

Poz.33. -

Kutia është e pajisur me një portë daljeje të kanalit të majtë, duke lejuar lidhje të lehtë me altoparlantin e kanalit të majtë.

Me të kaltër është pjesa e kërkesës që nuk është relevante.

Poz.34. -

Tensioni i Hyrjes AC: 100-240V

Furnizimi me Energji: 100-240V AC, 50/60Hz, 3A DC

Me të kaltër është pjesa e kërkesës që nuk është relevante.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mosrespektimi i dispozitave të LPP-së i shkakton operatorit ekonomik:

- Pamundësi reale për pjesëmarrje në procedurë;
- Humbje të mundësisë për konkurrim të barabartë;
- Dëmtim ekonomik dhe reputacional;
- Cenim të besimit të operatorëve ekonomikë në sistemin e prokurimit publik.

Ne si OE kemi shpenzime të konsiderueshme në përgatitjen e dokumentacionit, ofertave dhe pjesëve tjera të cilat ndërlidhet me këtë procedurë të prokurimit, shpenzimet për sigurimin e Ofertes, Shpenzimet e Avokatisë si ne përgatitjen e kërkesave për rishqyrtim ashtu edhe për përgatitjen e ankesës.

Dëmi refletkon në dëmin material dhe jo material e i cili shtrihet edhe në raport me LMD neni 136, 137 duke mos u kufizuar edhe edhe në dëmtimin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.